



Funded by
the European Union



Thirrje për aplikim : Psikolog/e (1)

Projekti: 4CRSVsurvivors-“Rrugët drejt fuqizimit: Promovimi i drejtësisë, shërimit dhe gjithëpërfshirjes për të mbijetuarit e dhunës seksuale lidhur me konfliktin”

Sfondi:

Si pjesë e projektit rajonal të BE-së “Mbështetje për ndërtimin e besimit në Ballkanin Perëndimor”, i financuar nga Bashkimi Evropian (BE) dhe i cili zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) si përfituese, do të plotësoj stafin në mënyrë që të përmbushë objektivat e projektit sa më mirë.

QKRMT është një organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 1999 që ofron shërbime ndërdisiplinore në mbështetje të viktimave civile të luftës, veçanërisht të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Më tej, QKRMT-ja është e përfshirë në identifikimin, vlerësimin, trajtimin, referimin dhe monitorimin e të mbijetuarve të dhunës me bazë gjinore në mesin e të riatdhesuarve dhe personave me shqetësim për UNHCR-në (të kthyerit, refugjatët, personat e zhvendosur brenda vendit dhe personat në rrezik të pashtetësisë).

Gjithashtu, në kuadër të mandatit të saj për të promovuar dhe avancuar respektimin e të drejtave të njeriut për personat e privuar nga liria, QKRMT kryen vizita të rregullta monitoruese në vendet si: burgje, qendra të paraburgimit, qelitë e paraburgimit të policisë, institucionet e shëndetit mendor dhe gjithashtu promovon praktikat dhe standardet legislative për mbrojtjen dhe ngritjen e nivelit të respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria.

Objektivat:

Kjo pozitë ka për qëllim ofrimin e mbështetjes psikosociale për të mbijetuarit e dhunës seksuale të lidhur me konfliktin, duke siguruar një qasje të ndjeshme, empatike dhe të besueshme. Detyrat kryesore përfshijnë:

I. Fusha e Punës për pozitën Psikologe

- Ofrimi i mbështetjes psikosociale për të mbijetuarit e dhunës seksuale lidhur me konfliktin në një mënyrë të ndjeshme, empatike dhe të besueshme.
- Realizimi i seancave individuale dhe grupe të terapisë që synojnë adresimin e traumës, menaxhimin e stresit dhe promovimin e shërimit.
- Zhvillimi dhe zbatimi i planeve të trajtimit të përshtatura për secilin të mbijetuar bazuar në nevojat dhe përvojat e tyre unike.

- Bashkëpunimi me anëtarë të tjerë të ekipit multidisiplinor për të siguruar kujdes dhe mbështetje holistike për të mbijetuarit.
- Mbjajtja e regjistrave të sakta dhe të besueshme të ndërveprimeve të klientëve, vlerësimeve dhe planeve të trajtimit në përputhje me politikat e organizatës dhe etikën profesionale.
- Përbushja e detyrave të tjera që përcaktohen nga mbikëqyrësi, duke përfshirë projekte të veçanta, përmirësime të proceseve, ose detyra administrative që ndihmojnë në funksionimin e përgjithshëm të organizatës apo institucionit.

Kualifikimet e nevojshme për Psikologe

- Diplomë universitare në Psikologji.
- Përvojë në ofrimin e këshillimit dhe shërbimeve të ndihmës psikosociale për të mbijetuarit e dhunës seksuale lidhur me konfliktin ose forma të tjera të traumës.
- Kuptim i nevojave dhe sfidave psikosociale që përballen të mbijetuarit, si dhe faktorëve kulturorë dhe kontekstual që ndikojnë në shërimin e tyre.
- Aftësi të shkëlqyera ndërpersonale dhe komunikimi, me aftësi për të krijuar marrëdhënie të mira terapeutike me klientë të ndryshëm.
- Aftësi për të punuar efektivisht si në mënyrë të pavarur ashtu edhe si pjesë e një ekipi multidisiplinor.
- Përkushtim për mbajtjen e standardeve etike dhe për mbajtjen e besimit të klientit.

Afati kohor:

Pozita e lartcekur është me kohë të caktuar, deri në fund të muajit janar 2025, me mundësi vazhdimi.

Raportimi:

Personi i përzgjedhur në këtë pozitë do t'i raportojë menaxherit të projektit të QKRMT-së dhe do të sigurojë përditësime të rregullta mbi progresin e punës.

Procesi i aplikimit:

Personat e interesuar ftohen të dorëzojnë CV-n dhe letrën motivuese, në info@krct.org dhe fnisnik.mehmeti@krct.org duke shënuar në subjekt të emailit "Psikolog/e 4CRSVsurvivors", **deri më 04.11.2024**

Shënim:

- Propozimet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen për proces të mëtejshëm. Propozimet e marra pas kohës së saktë të përcaktuar për pranimin e ofertës do të konsiderohen të vonuara dhe nuk do të vlerësohen.
- Kandidatët në listë të ngushtë do të ftohen për intervistë.